



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

---

**VENDIM**

**Nr. 172, datë 21.12.2012**

**MBI**

**KRIJIMIN E FONDIT TË KOMPENSIMIT**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, nenit 45, paragrafi 4, të Ligjit nr. 10 076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, me propozim të Byrosë Shqiptare të Sigurimit, Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Departamentit të Çështjeve Juridike, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**KONSTATOI SE:**

Në bazë të Ligjit nr. 10 076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, neni 45 “shoqëritë e sigurimit, të cilat ushtrojnë veprimtari në territorin e RSH në sigurimin e detyrueshëm motorik, janë të detyruara të kontribuojnë çdo vit financiarisht në fondin e kompensimit, në përpjestim të drejtë, me primet bruto të shkruara në këto lloj sigurimesh, në vitin paraardhës. Autoriteti, me propozim të Byrosë, vendos çdo vit shumën e kontributeve, sipas pikave 2 e 3 shkronja b, dhe afatin brenda të cilit duhet të bëhet derdhja.

Byroja Shqiptare e Sigurimit ka depozituar në Autoritet vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve nr. 147, datë 04.12.2012, me anë të së cilës ka miratuar shumën e kontributeve për fondin e kompensimit për vitin 2013”, sipas përlllogaritjeve të kryera nga aktuarët e shoqërive të sigurimit në vlerën 264,792,862 lekë.

Byroja raporton në Autoritet çdo muaj informacion mbi Fondin e Kompensimit, në bazë të Rregullores nr. 2, datë 28.01.2010, “Për standardet e raportimit dhe të mbikëqyrjes së BSHS-së”. BSHS me shkresën nr. 7712 prot, datë 12.11.2012, “Informacion mbi treguesit financiarë për periudhën janar-12 nëntor 2012”, informon se vlera e dëmeve të miratuara të papaguara, objekt i Fondit të Kompensimit, deri më 12 nëntor 2012, është në vlerën 420,951,378 lekë.

Fondi i propozuar nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve të BSHS-së, për vitin 2013, nuk është i mjaftueshëm për pagesën e dëmeve sipas parashikimeve neneve 21, 29, 30 dhe 31 të ligjit të mësipërm.

Autoriteti pas llogaritjeve përkatëse, përcakton se vlera reale e Fondit të Kompensimit për detyrimet objekt i këtij fondi deri më 31.12.2012 si dhe për përmbushjen e pagesave për vitin 2013, është në vlerën 623,273,498 lekë. Me këtë fond mund të mbulohen mungesat si dhe të sigurohet vijueshmëria e pagesave të dëmeve në përputhje me parashikimet ligjore.

Vlera e propozuar nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve të BSHS-së në shumën 264,792,862 lekë, është e pamjaftueshme, dhe në këto kushte kjo vlerë do të konsiderohet si kontribut vetëm për 6- mujorin e parë të vitit 2013.

Për sa më sipër Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

### **V E N D O S I:**

1. Detyrimi i shoqërive të sigurimit për pagesën e dëmeve objekt i Fondit të Kompensimit për vitin 2012, është në vlerën 420,951,378 lekë.
2. Byroja të njoftojë shoqëritë e sigurimit për detyrimin përkatës referuar pikës 1 të këtij vendimi. Shoqëritë e sigurimit, bazuar në Ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, duhet ta pasqyrojnë këtë detyrim në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2012.
3. Fondi i Kompensimit për 6-mujorin e parë të vitit 2013, është në vlerën 264,792,862 lekë.
4. Shoqëritë e sigurimit anëtare të BSHS-së të financojnë me dy këste të barabarta brenda datës 15 të çdo fillim të 3-mujorit të parë dhe të dytë të vitit 2013, shumën e kontributit në të njëjtin raport që zë secili anëtar në fondin e kompensimit të përcaktuar në pikën 3, të këtij vendimi.
5. BSHS, bazuar në nenin 45, të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009, të depozitojë në Autoritet, brenda datës 10 qershor 2013, propozimin e Fondit të Kompensimit për 6-mujorin e dytë të vitit 2013.
6. Ngarkohet Byroja dhe departamentet përkatës për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Enkeleda SHEHI**